- Avujt alkoolik mund të ndizen në hapësirën e nxehtë për zierje. Asnjëherë mos përgatitni gjellë me sasi të mëdha të pijeve që përmbajnë përqindje të lartë të alkoolit. Përdorni vetëm sasi të vogla të pijeve që përmbajnë përqindje të lartë të alkoolit. Derën e aparatit e hapni me kujdes.

Rrezik nga djegia!

- Pjesët e arritshme gjatë punës bëhen të nxehta. Mos i prekni asnjëherë pjesët e nxehta. Fëmijët i mbani larg.
- Gjatë hapjes së derës së aparatit mund ta dalë avull i nxehtë. Derën e aparatit e hapni me kujdes. Fëmijët i mbani larg.
- Në saje të ujit në hapësirën e nxehtë për zierje mund të formohet avull i nxehtë. Asnjëherë mos derdhni ujë në hapësirën e nxehtë për zierje.

Rrezik nga lëndimi!

Qelqi i gërvishtur i derës së aparatit mund të pëlcasë. Mos përdorni kruese qelqi, mjete të sërta ose fërkuese për pastrim.

Rrezik nga goditja e rrymës!

- Riparimet e gabuara janë të rrezikshme. Riparimin guxon ta bëjë vetëm një teknik i shkolluar në shërbimin tonë të klientëve. Nëse aparati është në defekt, hiqeni spinën e rrjetit ose fikni siguresën në arkën e siguresave Thirrni shërbimin e klientëve
- Në pjesët e nxehta të aparatit izolimi i kabllor së aparateve elektrike mund të shkrihet. Kabllon e lidhjes së aparateve elektrike asnjëherë mos e sillni në kontakt me pjesët e nxehta të aparatit.
- Lagështia që depërton mund të shkaktojë një goditje të rrymës. Mos përdorni pastrues me presion ose pastrues me avull.
- Gjatë ndërrimit të llambës së hapësirës për zierje kontaktet e fasungës kanë rrymë. Para ndërrimit hiqeni spinën e rrjetit ose fikni siguresën në arkën e siguresave.
- Një aparat me defekt mund të shkaktojë një goditje të rrymës. Asnjëherë mos e ndizni një aparat me defekt. Hiqni spinën e rrjetit ose fikni siguresën në arkën e siguresave. Thirrni shërbimin e klientëve

Shkaqet e dëmtimeve


Kujdes!

- Pajisje, fletë, letër për pjekje ose enë në dyshemenë e hapësirës për zierje Mos shtroni pajisje në dyshemenë e hapësirës për zierje. Dyshemenë e hapësirës për zierje mos e shtroni me asnjë fletë pa marrë parasysh e cilit lloj, dhe as me letër për pjekje. Mos vendosni enë në dyshemenë e hapësirës për zierje, nëse është rregulluar një temperaturë mbi 50 °C. Krijohet një pengesë e ngrohtësisë. Më nuk do të jetë e saktë koha e pjekjes dhe skuqjes dhe do të dëmtohet emali.
- Uji në hapësirën e nxehtë për zierje Asnjëherë mos derdhni ujë në hapësirën e nxehtë të zierjes. Kështu krijohet avull uji. Nga ndryshimet e temperaturës shkaktohen dëmtime të emalit.
- Ushqime të lëngshme: Mos ruani ushqime të lëngshme për kohë më të gjatë në hapësirën për zierje të mbyllur. Do të dëmtohet emali.

- Lëng pemësh: Te ëmbëlsirat e pemëve me shumë lëng, tepsinë për pjekje mos e mbushni shumë. Lëngu i pemëve, i cili pikon nga tepsia e pjekjes, krijon njolla, të cilat pastaj nuk largohen. Nëse është e mundur, përdorni tiganin e thellë universal.
- Ftohje me derën e hapur të aparatit: Hapësira për zierje lihet të ftohet vetëm në gjendje të mbyllur. Edhe nëse dera e aparatit është e hapur vetëm për një dhëmb, ballinat mobilieve fqinje me kalimin e kohës mund të dëmtohen.
- Shtupësi i derës i ndotur fortë Nëse shtupësi i derës është shumë i ndotur, dera e aparatit gjatë punës më nuk mund të mbyllet si duhet. Ballinat e mobilieve fqinje mund të dëmtohen. Shtupësin e derës e mbani gjithmonë të pastër.
- Dera e aparatit si sipërfaqe për ulje ose si vend për vendosje: Mos vendosni, ulni, ose varni në derën e aparatit. Mos vendosni enë ose pajisje mbi derën e aparatit.
- Futja e pajisjeve: Varësisht nga tipi i aparatit pajisja gjatë mbylljes mund ta gërvishtë fletën e derës së aparatit. Pajisjen gjithmonë e futni në hapësirën për zierje deri në një goditje.
- Transportimi i aparatit: Mos e mbartni ose lëvizni aparatin duke e kapur për dorezën e derës. Doreza e derës nuk e mban peshën e aparatit, andaj dhe mund të thyhet.

Pajisja juaj e re

Këtu do të njiheni me pajisjen tuaj të re. Do të merrni informacione për panelin e komandimit, për furrën, llojet e ngrohjes dhe aksesoret.



Shpjegim

- | | |
|---|--------------------------|
| 1 | Ora elektronike |
| 2 | Zgjedhësi i funksioneve |
| 3 | Llamba treguese |
| 4 | Zgjedhësi i temperaturës |

Zgjedhësi i funksioneve

Me anë të zgjedhësit të funksioneve, rregulloni llojin e ngrohjes.

Pozicioni	Përdorimi
○ Pozicioni zero	Furra është e fikur.
☐ Ngrohje e sipërme/e poshtme	Për kekët, tavat dhe copave të holla të mishit të pjekur, p.sh. mish lope ose mish i egër, në një nivel rafti. Nxehtësia vjen njëtrajtshëmrisht si lart ashtu edhe poshtë.
⊗ Ajër i nxehtë	Për kekët dhe pastat në një deri dy nivele. Për kekët dhe pastat në një deri tre nivele.

* Lloji i ngrohjes me të cilin kategoria e efikasitetit të energjisë është përputhur me normat EN 50304.

Pozicioni	Përdorimi
⊗ Ajër i nxehtë Eco*	Për kekët dhe pastat në një deri dy nivele. Për kekët dhe pastat në një deri tre nivele. Në këtë lloj ngrohjeje ndriçimi i furrës do të fiket.
☐ Qarkullimi i ajrit	Për kekët, pastat dhe picat e freskëta në një deri dy nivele. Ventilatori shpërndan njëtrajtshëmrisht elementët e nxehtësisë në dhomëzën e gatimit.
⊗ Gradacioni i picës	Përgatitje e shpejtë e produkteve të ngrira pa ngrohje paraprake, p.sh. pica, patate të skuqura ose strudel. Elementi i poshtëm i nxehtësisë dhe elementi rrethor i nxehtësisë ngrohin murin e pasmë.
☐ Skara me qarkullim ajri	Pjekje mishi, shpendësh dhe peshku të plotë. Elementi nxehtës dhe ventilatori ndizen dhe fiken me alternim. Ventilatori e qarkullon ajrin e nxehtë rrotull gatesës.
☐ Skara me sipërfaqe të madhe	Pjekja në skarë e biftekëve, salsiçeve, tosteve dhe copave të peshkut. E gjithë sipërfaqja nën elementin nxehtës të skarës do të nxehet.
☐ Skara me sipërfaqe të vogël	Pjekja në skarë e sasive të vogla të biftekëve, salsiçeve, tosteve dhe copave të peshkut. Pjesa qendrore e elementit nxehtës të skarës do të nxehet.
☐ Ngrohja e poshtme	Për zierjen e mëtejshme të gatesave. Nxehtësia vjen vetëm nga poshtë.
⊗ Ndriçimi	Ndriçimi i furrës është i ndezur.

* Lloji i ngrohjes me të cilin kategoria e efikasitetit të energjisë është përputhur me normat EN 50304.

Udhëzim: Kur vendosni llojin e ngrohjes, llamba e furrës ndizet brenda dhomëzës së gatimit.

Udhëzim: Në llojin e ngrohjes "Ajër i nxehtë-Eco", ndriçimi i furrës do të fiket.

Zgjedhësi i temperaturës

Me anë të çelësit të temperaturës, rregulloni temperaturën ose gradacionin e skarës.

Pozicioni	Kuptimi
●	Pozicioni zero Furra nuk nxehet.
50-250	Gama e temperaturës Temperatura në dhomëzën e gatimit në °C.

Kur furra nxehet, llamba treguese do të ndriçojë. Gjatë pushimeve të nxehtësisë ajo do të fiket.

Ora elektronike

Me anë të orës elektronike mund të kontrolloni furrën. Kështu mund të zgjidhni për shembull kohën në të cilën furra do të ndizet ose kohën e fikjes automatike, në të cilën pjekja ose procesi i gatimit do të përfundojë. Ora elektronike mund të përdoret edhe si alarm afatshkurtër.




Butoni i funksionit të orës elektronike


Simboli	Kuptimi	Përdorimi
🕒	Ora elektronike	Rregullimi i kohëzgjatjes ose kohës
-	Minus	Zvogëlimi i kohëzgjatjes ose kohës
+	Plus	Zgjatja e kohëzgjatjes ose kohës

Aksesori

Aksesorin mund ta futni në 4 lartësi të ndryshme në dhomëzën e gatimit. Shtyjeni gjithmonë mirë deri sa të mbërthehet, në mënyrë që aksesori të mos e prekë xhamin e derës. Bëni kujdes që aksesorin ta shtyni gjithmonë si duhet.



Ju mund ta nxirrni aksesorin tërësisht me ndihmën e shinave rrëshqitëse.



Ju mund ta nxirrni aksesorin deri në dy të tretat e saj jashtë, pa rrezikuar përmbyshjen e saj. Në këtë mënyrë mund t'i nxirrni lehtësisht gatesat.

Kur nxehet, aksesori mund të shformohet. Sapo të jetë ftohur, shformimi zhduket sërish dhe nuk ndikon më në funksionim.

Aksesorët e veçantë mund t'i blini pranë shërbimit të klientit, në dyqanet e specializuar ose në internet.

Aksesori	Përshkrimi
	Skarë pjekjeje dhe thekjeje Për enë, kallëpe ëmbëlsirash, mish të pjekur, copa mishi në skarë, gatesa të ngrira.
	Tavë pjekjeje e emaluar Për ëmbëlsira të lëngshme, pasta, gatesa të ngrira dhe mish rosto të madh. E përdorshme edhe si pritëse e yndyrave.
	Kunjat siguroes Për bllokimin e menteshës.

Para përdorimit të parë

Këtu do të zbuloni se çfarë duhet të bëni përpara se të përgatisni gatesën në pajisjen tuaj për herë të parë. Lexoni paraprakisht kapitullin *Udhëzime sigurie*.

Hiqni ambalazhin e pajisjes dhe mënjanojeni atë si duhet.

Rregullimi i orës

Pas lidhjes elektrike të pajisjes ose pas ikjes së korrentit, në tregues pulsojnë tre zero dhe simboli "A".

1. Shtypni butonin \ominus , derisa në tregues të pulsojë pika.

2. Rregulloni orën aktuale me butonat "+" ose "-".

Pas 7 sekondash, koha e zgjedhur do të regjistrohet.

Udhëzim: Për të ndryshuar orën e vendosur, shtypni butonat "+" dhe "-", derisa në tregues të pulsojë pika. Më pas rregulloni orën aktuale me butonat "+" ose "-".

Ngrohni furrën

Pastroni furrën paraprakisht

1. Nxirrni aksesoren dhe skarën e lëvizshme nga dhomëza e gatimit.

2. Hiqni nga furra gjithë mbetjet e ambalazhit, p.sh. pjesëzat prej stiropori.

3. Disa pjesë janë të mbuluara me letër mbrojtëse kundër gërvishjeve. Hiqni letrën mbrojtëse kundër gërvishjeve.

4. Pastrojeni pajisjen nga jashtë me një leckë të butë dhe të njomë.

5. Pastrojeni dhomëzën e gatimit me solucion shpëlarës të nxehtë.

Ngrohni furrën

Për të mënjeluar erën e pajisjes së re, ngrohni furrën e boshatisur e të mbyllur.

1. Rrotulloni zgjedhësin e funksioneve në ngrohjen e sipërme/të poshtme të llojit të ngrohjes.

2. Rrotulloni zgjedhësin e temperaturës në temperaturën maksimale.

3. Fikni furrën pas 40 minutash.

Pastrojeni më pas furrën

1. Pastrojeni dhomëzën e gatimit me solucion shpëlarës të nxehtë.

2. Montoni skarën e lëvizshme.

Pastroni aksesoren

Përpara se ta përdorni aksesoren, pastrojeni atë mirë me solucion të ngrohtë dhe me një leckë të butë.

Kështu duhet ta përdorni furrën tuaj

Elementë komandues me shtypje

Zgjedhësi i funksioneve dhe zgjedhësi i temperaturës janë me shtypje. Për mbërthimin dhe zbërthimin, shtypni elementin përkatës komandues.

Ndezja e furrës

1. Me zgjedhësin e funksionit, vendosni llojin e ngrohjes.

2. Me zgjedhësin e temperaturën vendosni temperaturën.

Furra fillon të nxehet.

Fikni furrën

Rrotulloni zgjedhësin e funksioneve dhe zgjedhësin e temperaturës në pozicionin zero.

Ndryshimi i rregullimeve

Ju mund ta ndryshoni llojin e ngrohjes dhe temperaturën e gradacionin e grillit në çdo kohë me secilin nga përzgjedhësit.

Ngrohja

Ngroheni mundësisht shpejt dhomëzën e gatimit, përdorni "llojin e ngrohjes" "me qarkullim ajri". Kur të arrihet temperatura e dëshiruar (llamba treguese është fikur), vendosni llojin e dëshiruar të ngrohjes.

Përdorimi i orës elektronike

Në tregues mund të shfaqen sërish krahas orës dhe kohës së mbetur, simbolet e mëposhtëm:

Simboli	Kuptimi
•	Pika midis treguesit të orëve dhe minutave. Pulson kur ora mund të rregullohet.
\triangle	Alarmi i shkurtër Tregon statusin e procesit të alarmit të shkurtër.
A	Modaliteti automatik Tregon statusin e procesit të modalitetit automatik.
⏏	Disponueshmëria për punë Nëse shfaqet kjo shenjë, furra është e disponueshme për punë.

Rregullimi i orës

Pas lidhjes elektrike të pajisjes ose pas ikjes së korrentit, në tregues pulsojnë tre zero dhe simboli "A".

1. Shtypni butonin \ominus , derisa në tregues të pulsojë pika.



2. Rregulloni orën aktuale me butonat "+" ose "-".

Pas 7 sekondash, koha e zgjedhur do të regjistrohet.




Udhëzim: Për të ndryshuar orën e vendosur, shtypni butonat "+" dhe "-", derisa në tregues të pulsojë pika. Më pas rregulloni orën aktuale me butonat "+" ose "-".

Rregulloni alarmin e shkurtër

Alarmi i shkurtër nuk ka asnjë ndikim në funksionet e furrës. Kohëzgjatja e alarmit të shkurtër mund të rregullohet nga 1 minutë deri në 23 orë e 59 minuta.

1. Shtypni butonin , derisa në tregues të pulsojë simboli  dhe të shfaqen 3 zero.
2. Rregulloni kohëzgjatjen e dëshiruar me butonat "+" ose "-". Pas përfundimit të kohës do të tingëllojë një sinjal akustik.

Udhëzime

- Për të ndryshuar kohën e mbetur, shtypni butonin , derisa në tregues të pulsojë simboli . Më pas, ndryshoni kohën e mbetur me butonat "+" dhe "-".
- Për fikjen e rregullimit, shtypni butonin , derisa simboli të pulsojë në tregues. Më pas, shtypni njëkohësisht butonat "+" dhe "-".


Fikja e tingullit sinjalizues

Shtypni butonin , derisa simboli  të fiket.

Pas shtatë minutash, sinjali do të fiket automatikisht.

Ndryshoni tingullin sinjalizues




Keni në dispozicion 3 tinguj të ndryshëm sinjalizues.

1. Shtypni njëkohësisht butonat "+" dhe "-".
2. Shtypni butonin .
Në panelin e treguesve do të shfaqet tingulli aktual sinjalizues, p. sh. "tingulli 1".
3. Shtypni butonin "-" për të zgjedhur një tjetër tingull sinjalizues.

Vendosni kohën e fikjes automatike



Në orën elektronike mund ta ndizni ose fikni furrën automatikisht.

Fikja automatike

1. Shtypni butonin , derisa në tregues të pulsojë simboli  dhe të shfaqen 3 zero.
2. Shtypni sërish butonin e funksionit , derisa në panelin e treguesve të pulsojnë me alternim "dur" dhe "0.00" dhe simboli "A" blinken.
3. Rregulloni kohëzgjatjen me butonat "+" ose "-".
Kohëzgjatja e procesit mund të rregullohet nga 1 minutë deri në 10 orë.
4. Rregullimi i llojit të dëshiruar të ngrohjes dhe temperaturës.
Furra starton dhe në panelin e treguesve shfaqen simboli **A** dhe ora aktuale.






Kohëzgjatja e procesit ka përfunduar

Do të tingëllojë një sinjal akustik, në panelin e treguesve do të zhduket simboli  dhe simboli **A** do të pulsojë.


1. Fikni zgjedhësin e funksioneve dhe zgjedhësin e temperaturës.
2. Shtypni butonin , derisa të shfaqet simboli .
Furra do të fiket sërish në modalitetin manual.



Ndezja dhe fikja automatike

Pjekja ose thekja fillon për kohëzgjatjen e vendosur, në një moment të mëvonshëm të zgjedhur prej jush.

1. Shtypni butonin , derisa në tregues të pulsojë simboli  dhe të shfaqen 3 zero.
2. Shtypni sërish butonin e funksionit , derisa në panelin e treguesve të pulsojnë me alternim "dur" dhe "0.00" dhe simboli "A" blinken.
Ora aktuale është p.sh. 17:30.
3. Me butonat "+" ose "-" rregulloni kohëzgjatjen (p.sh. 1 orë).
Kohëzgjatja e procesit mund të rregullohet nga 1 minutë deri në 10 orë.
4. Shtypni sërish butonin e funksionit , derisa në panelin e treguesve të pulsojnë me alternim "End" dhe koha e fikjes "18:30" (ora aktuale plus kohëzgjatjen e zgjedhur të procesit).
5. Rregulloni kohën e fikjes me butonat "+" ose "-" (p.sh. 19:30).
Koha e fikjes mund të rregullohet deri në 23 orë dhe 59 minuta.
6. Rregullimi i llojit të dëshiruar të ngrohjes dhe temperaturës.
Në panelin e treguesve do të zhduket simboli .
Furra starton në këtë shembull në orën 18:30 dhe fiket sërish në orën 19:30.

Kohëzgjatja e procesit ka përfunduar



Do të tingëllojë një sinjal akustik, në panelin e treguesve do të zhduket simboli  dhe simboli **A** do të pulsojë.

1. Fikni zgjedhësin e funksioneve dhe zgjedhësin e temperaturës.
2. Shtypni butonin , derisa të shfaqet simboli .
Furra do të fiket sërish në modalitetin manual.

Shfaqja dhe ndryshimi i vlerave të vendosura





Vlerat e vendosura dhe koha e mbetur e llojeve të ndryshme të proceseve të orës elektronike, mund të shfaqen dhe të ndryshohen në çdo kohë në panelin e treguesve.

Shfaqja e kohës së mbetur të alarmit të shkurtër

Shtypni butonin , derisa në tregues të pulsojë simboli .

Në tregues do të shfaqet koha e mbetur dhe mund të ndryshohet me butonat "+" dhe "-".

Shfaqja dhe ndryshimi i kohëzgjatjes së procesit dhe kohës së fikjes.

1. Shtypni butonin , derisa në panelin e treguesve të pulsojë simboli .
2. Shtypni sërish butonin , derisa në panelin e treguesve të pulsojnë me alternim "dur" dhe kohëzgjatja e procesit dhe simboli **A**.
Kohëzgjatja e procesit mund të ndryshohet me butonat "+" ose "-". Përmes shtypjes njëkohësisht të butonave "+" dhe "-", fikja automatike do të fiket.
3. Shtypni sërish butonin , derisa në panelin e treguesve të pulsojnë me alternim "End" dhe koha e vendosur e fikjes.
Koha e fikjes mund të ndryshohet me butonat "+" ose "-". Përmes shtypjes njëkohësisht të butonave "+" dhe "-", fikja automatike do të fiket.

Mirëmbajtja dhe pastrimi

Në rast se kujdeseni dhe e pastroni furrën tuaj si duhet, ajo do të jetë në gjendje të mirë dhe funksionale për një kohë të gjatë. Më poshtë do t'ju shpjegojmë sesi të kujdeseni dhe si ta pastroni furrën tuaj si duhet.

Udhëzime

- Disa materiale të ndryshme, si pjesët prej qelqi, plastike ose metali në pjesën ballore të furrës mund të pësojnë çngjyrosje të lehta.
- Hijet në xhamin e derës, që duken si vija, janë reflekset e dritës së llambës së furrës.
- Si pasojë e temperaturave shumë të larta, shtresa e emailit digjet. Për këtë arsye mund të krijohen çngjyrosje të vogla. Kjo është normale dhe nuk ka asnjë ndikim në funksionim. Qoshet e tavave të holla nuk emalohen plotësisht. Për këtë arsye mund të jenë të ashpra. Mbrojtja nga gërryerja nuk do të ndikohet nga kjo.

⚠ Rrezik nga goditja e rrymës!

Lagështia që depërton mund të shkaktojë një goditje të rrymës. Mos përdorni pastrues me presion ose pastrues me avull.

⚠ Rrezik nga djegia!

Aparati bëhet shumë i nxehtë. Mos i prekni asnjëherë sipërfaqet e brendshme të nxehta të hapësirës së zierjes ose elementet nxehtë. Aparatin e leni gjithmonë të ftohet. Fëmijët i mbani larg.

Mjet për pastrim

Në mënyrë që sipërfaqet e ndryshme të mos dëmtohen si pasojë e përdorimit të mjeteve të papërshtatshme të larjes, respektoni të dhënat e mëposhtme.

Mos përdorni

- mjete larës të mprehtë ose gërryes
- mjete pastrues të fortë e me përmbajtje alkooli
- tela të ashpër ose sfungjerë agresivë
- mjete larës me presion të lartë ose me avull.

Pecetat prej sfungjeri, lajini mirë para se t'i përdorni.

Zona	Mjet për pastrim
Aparati nga ana e jashtme	Solucion shpëlarës i nxehtë: Pastroni me një leckë larëse dhe thajeni më pas me një leckë të butë. Mos përdorni pastrues për xhama ose kruajtëse xhamash.
Çelik inoks	Solucion shpëlarës i nxehtë: Pastroni me një leckë larëse dhe thajeni më pas me një leckë të butë. Pastroni menjëherë njollat e çmërsit, yndyrës, niseshtesë dhe të bardhës së vezës. Këto njolla mund të krijojnë gërryerje të sipërfaqeve. Pranë shërbimit të klientit ose në dyqanet e specializuara mund të gjeni mjete larës të posaçëm për çelikun që janë të përshtatshme për sipërfaqet e ngrohta. Vendorsni vetëm një shtresë të hollë mjete larës me një leckë të butë.
Alumin dhe plastikë	Pastrues për xhamat: Pastrojini me një leckë të butë.

Zona	Mjet për pastrim
Sipërfaqet e emaluara (sipërfaqet të lëmuara)	Për një pastrim më të lehtë mund të ndizni dritën e furrës dhe nëse është nevojë çmontoni derën e furrës. Përdorni lëndë larëse të tregut ose ujë me kripë me një leckë ose fshirëse xhamash të butë dhe të njomë; më pas thajeni me një leckë të butë. Zbutni mbetjet e djegura të ushqimeve me një leckë të njomë dhe me solucion larës. Në rastin e ndotjeve të mëdha, ju këshillojmë pastrues furre në formë xheli. Ai mund të përdoret posaçërisht për këtë punë. Pas pastrimit, lëreni dhomëzën e gatimit hapur që të thahet.
Sipërfaqet vetëpastruese (sipërfaqet e ashpër)	Bëni kujdes udhëzimet në kapitullin: Sipërfaqet vetëpastruese
Xhamat e derës	Pastrues për xhamat: Pastrojini me një leckë të butë. Mos përdorni kruajtëse xhamash.
Mbulesa e qelqtë e llambës së furrës	Solucion shpëlarës i nxehtë: Pastrojini me një leckë larëse.
Guarnicioni Mos e hiqni!	Solucion shpëlarës i nxehtë: Pastrojini me një leckë larëse. Mos e fërkoni.
Raftet	Solucion shpëlarës i nxehtë: Zbuteni dhe pastrojini me një leckë larëse ose me një furçë.
Aksesorit	Solucion shpëlarës i nxehtë: Zbuteni dhe pastrojini me një leckë larëse ose me një furçë.

Veshje katalitike e dhomëzës së gatimit

Veshjet katalitike të dhomëzës së gatimit janë të veshura me smalt vetëpastrues.

Kur furra është në punë e sipër, sipërfaqet pastrohen vetë. Spërkatjet e mëdha do të zhduken vetëm pas disa përdorimeve të furrës.

Sipërfaqet vetëpastruese

Muret anësore kanë veshje katalitike. Mos i pastroni asnjëherë këto sipërfaqet me pastrues furre. Çngjyrosja e lehtë e shtresës së emaluar nuk ka ndikim në pastrimin automatik.


Montimi dhe çmontimi fletëve të derës

Për pastrim më të mirë fletët e qelqit në derën e furrës mund ti çmontoni.

Çmontimi i xhamave të derës

1. Derën e furrës hapeni plotësisht.
2. Blllokoni dy menteshat majtas dhe djathtas me kunjjin sigurues.


Udhëzim: Kunjzat sigurues duhet të jenë futur plotësisht në vrimat e menteshës.




3. Ngrini lehtë pjesën e poshtme të xhamit të brendshëm, derisa kunjat fiksues të lirohen nga mbajtëset (1).
4. Ngrini me kujdes pjesën e sipërme të xhamit të brendshëm, derisa kunjat fiksues të lirohen nga mbajtëset (2).

Kujdes!


Duke ngritur xhamin e brendshëm, xhami i mesëm mund të mbetet ngecë tek i brendshmi. Sigurohuni që xhami i mesëm të mos bjerë poshtë.



5. Nxirrni jashtë xhamin e brendshëm.
6. Nxirrni jashtë xhamin e mesëm.



Udhëzim: Xhami i mesëm nuk është shtrënguar me kunjja fiksues, por qëndron në pozicion me ndihmën e mbajtëseve prej gome.



Pastrojeni xhamin me pastrues xhamash dhe me një leckë të butë.

⚠ Rrezik nga lëndimi!

Qelqi i gërvishtur i derës së aparatit mund të pëlçasë. Mos përdorni kruese qelqi, mjete të sërta ose fërkuese për pastrim.

Montimi i xhamave të derës

1. Vendoseni sërish xhamin e mesëm.

Udhëzim: Bëni kujdes që xhami të pozicionohet mirë. Të gjitha mbajtëset prej gome duhet të vendosen horizontalisht mbi xhamin e jashtëm.

2. Vendosni sërish xhamin e brendshëm.

Udhëzim: Gjithë kunjat fiksues duhet të mbërthehen në mbajtëset e parashikuara posaçërisht.

3. Hiqni kunjat sigurues dhe mbyllni dyert e furrës.

Çmontimi dhe montimi i derës së pajisjes


Në rastin e ndotjeve të mëdha, dera e furrës mund të çmontoni derën për një pastrim më të mirë. Zakonisht kjo nuk është domosdoshmërisht e nevojshme.

Çmontimi i derës së pajisjes

1. Derën e furrës hapeni plotësisht.
2. Blllokoni dy menteshat majtas dhe djathtas me kunjjin sigurues (a).

Udhëzim: Kunjzat sigurues duhet të jenë futur plotësisht në vrimat e menteshës.

3. Kapeni derën e furrës në anë me të dy duart dhe mbylleni derën e furrës rreth 30° (b).




4. Ngrijeni lehtë derën e furrës dhe nxirrni atë jashtë.

Udhëzim: Mos e mbyllni plotësisht derën e furrës. Menteshat mund të përkulen dhe sipërfaqja e emaluar mund të dëmtohet.

Montimi i derës së pajisjes

1. Kapeni derën e furrës në anë me të dy duart.
2. Shtyjini menteshat në foletë e furrës (a).

Udhëzim: Kanali nën mentesha duhet të mbërthehet në skajet e furrës (b).



3. Uleni derën poshtë.
4. Hiqni kunjat sigurues.

⚠ Rrezik plagosjeje!

Kur dera e furrës bie ose kur thyhet mentesha, mos e kapni nga mentesha. Telefonojni shërbimit të klientëve.


Çmontimi dhe montimi i skarës së lëvizshme

Për një pastrim më të mirë, mund ta çmontoni skarën e lëvizshme.

Çmontoni skarën e lëvizshme

Skarat e lëvizshme janë gjithmonë të shtrënguara brenda dhomëzës së gatimit, në tre pika të mureve anësorë.

1. Kapini skarat e lëvizshme në pjesën e përparme dhe tërhiqini në mes të dhomëzës së gatimit.
Çngeli i përparmë i skarës së lëvizshme lirohet nga vrima.
2. Palosni sërish skarën e lëvizshme dhe tërhiqeni nga vrima e pasme në murin anësor.
3. Puthitni veshjen katalitike të dhomëzës së gatimit.
4. Nxirrni skarën e lëvizshme nga dhomëza e gatimit.



Montoni skarën e lëvizshme

1. Puthitni veshjen katalitike të dhomëzës së gatimit.
2. Futni çengelët e skarës së lëvizshme në vrimat e pasme të murit të pasmë.
3. Shtypeni çngelin e përparmë të skarës së lëvizshme tek vrima përkatëse.

Një pengesë, çka duhet bërë?

Nëse paraqitet një pengesë, në të shumtën e rasteve bëhet fjalë për ndonjë imtësinë. Para se të thirrni shërbimin e klientëve, përfillni ju lutemi udhëzimet në vijim..

Pengesë	Shkaqet e mundshme	Udhëzime/Ndihmë
Aparati nuk funksionon.	Siguresa në defekt.	Shihni në arkën e siguresave, nëse siguresa për shporetin është në rregull.
	Ndërprerje rryme.	Kontrolloni, nëse llamba e kuzhinës funksionon.
Fikja e furrës nuk është e mundur.	Elektronika është në defekt.	Fikni siguresën. Thirrni shërbimin e klientëve
Treguesi i orës xixëllon.	Rënie e rrymës	Kohën e orës e rregulloni sërish.
Furra nuk nxehet.	Siguresa në defekt.	Kontrollojeni siguresën ose zëvendësojeni me të re.
	Zgjedhësi i funksioneve nuk është rregulluar.	Rregullimi i zgjedhësit të funksioneve.
Qelqi i derës është i thyer.		Fikni aparatën. Thirrni shërbimin e klientëve
Lëng pemësh ose njolla nga e bardha e vezë në sipërfaqet e emaluara.	Ëmbëlsira të njoma ose lëngje pemësh.	Ndryshim i lehtë i emalit, i pandreqshëm.

⚠ Rrezik nga goditja e rrymës!

Riparimet e gabuara përbajnë rrezik. Riparimin guxon ta bëjë vetëm një teknik i shkolluar në shërbimin tonë të klientëve. Rregullimet joprofesionale të aparatit mund të sjellin rrezik të madh.

Ndërrimi i llambës së furrës


Kur llamba e furrës digjet, duhet të zëvendësohet. Llambat e rezistueshme ndaj temperaturës i gjeni pranë shërbimit të klientit ose në dyqanin e specializuar. Lutemi jepni numrin e produktit (E-Nummer) dhe numrin e datës së prodhimit (FD-Nummer) të pajisjes tuaj. Mos përdorni asnjë llambë tjetër.

⚠ Rrezik nga goditja e rrymës!

Gjatë ndërrimit të llambës së hapësirës për zierje kontaktet e fasungës kanë rrymë. Para ndërrimit hiqeni spinën e rrjetit ose fikni siguresën në arkën e siguresave.

1. Lëreni dhomëzën e gatimit të ftohet.
2. Hapni derën e pajisjes.
3. Vendoseni pecetën e enëve në dhomëzën e gatimit, për të shmangur dëmet.
4. Nxirrni skarën e lëvizshme.
5. Hiqni mbulesën e qelqtë. Hapni nga përpara me dorë mbulesën e qelqtë. Nëse hasni vështirësi në heqjen e mbulesës së qelqtë, përdorni një lugë.

6. Nxirrni llambën e furrës.



7. Zëvendësoni llambën e furrës me një llambë të të njëjtit lloj:

Tensioni: 230 V;

Fuqia: 40W;

Spina: G9;

Qëndrueshmëria e temperaturës: 300 °C

8. Vendosni sërish mbulesën e qelqtë të llambës së furrës.

9. Montoni skarën e lëvizshme.

10. Nxirrni sërish pecetën e enëve.

11. Ndizni përsëri siguresën.

12. Kontrolloni nëse llamba e kuzhinës funksionon sërish.

Shërbimi i klientëve

Nëse pajisja juaj duhet të riparohet, shërbimi jonë për klientët qëndron në dispozicionin tuaj. Ne gjithmonë gjejmë një zgjidhje të përshtatshme, gjithashtu për të evituar vizita të panevojshme nga ana e teknikut.

Numri i produktit (E-Nummer) dhe numri i datës së prodhimit (FD-Nummer)

Kur të telefononi, ju lutemi jepni numrin e prodhimit (E-Nr.) dhe numrin e datës së produktit (FD-Nr.), në mënyrë që t'ju japim një ndihmë të kualifikuar. Tabelën e tipit me numrat e gjeni në pjesën e poshtme të dhomëzës së gatimit, kur dera e furrës është e hapur. Në mënyrë që të mos ju duhet të kërkoni për shumë kohë, mund të regjistroni këtu të dhënat e pajisjes tuaj dhe numrat e telefonit të shërbimit të klientit.

E-Nr. (Numri i produktit)

FD-Nr. (Numri i datës së prodhimit)

Shërbimi i klientëve ☎

Mbani parasysh se vizita e teknikut të shërbimit të klientit në rastin e një keqfunksionimi nuk është pa pagesë edhe brenda periudhës së garancisë.

Të dhënat e kontaktit për të gjitha vendet i gjeni në listën e përmbajtjes të shërbimit të klientëve.

Kini besim te kompetenca e prodhuesit. Kështu mund të jeni të sigurt se riparimin do ta realizojnë teknikët e trajnuar për riparim, të cilët janë të pajisur me pjesë këmbimi origjinale për pajisjet tuaja.

Këshilla për energjinë dhe mjedisin

Këtu mund të gjeni këshilla, sesi të kurseni energji gjatë gatimit ose pjekjes dhe sesi ta mënjanoni pajisjen siç duhet.

Kursim i energjisë

- Nxehni furrën paraprakisht nëse kjo është cilësuar në recetë.
- Përdorni tava pjekjeje me ngjyrë të errët, të zeza dhe të llakuara ose të emaluara. Ato e thithin veçanërisht mirë nxehtësinë.
- Hapni sa më rrallë derën e furrës gjatë zierjes, pjekjes ose thekjes.
- Kur ka disa kekë, ata piqen më mirë njëri pas tjetrit. Furra është ende e ngrohtë. Në këtë mënyrë shkurtohet koha e pjekjes për kekun e dytë. Mund të futni edhe 2 forma keku njëkohësisht pranë njëra-tjetrës.
- Për kohë gatimi më të gjata, mund ta fikni furrën 10 minuta para përfundimit të gatimit dhe të përdorni nxehtësinë e mbetur.

Hedhja sipas normave ekologjike

Hidheni paketimin sipas normave ekologjike.



Ky aparat përmban shënjen e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2012/19/EU (waste electrical and electronic equipment - WEEE).

Udhëzimi jep kuadrin ligjor për të drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

Akrilamidi në ushqime

Akrilamidi krijohet kryesisht te produktet e drithit dhe patateve që përgatiten në temperatura të larta si p. sh patatinat, pomfriti, tostet, bukëzat, buka ose të pjekura fine (gurabijet, biskotat me mjaltë, spekulatius).

Këshilla për përgatitjen e gjellëve me përmbajtje të vogël akrilamidi.

Në përgjithësi	<ul style="list-style-type: none">■ Koha e zerjes duhet të jetë sa më e shkurtër.■ Gjellët piqini sa të marrin ngjyrë të verdhë në të artë; nuk duhet të marrin ngjyrë kafe.■ Sa më e madhe dhe sa më e trashë të jetë gjella, aq më pak përmban Akrilamid.
Pjekja	Me nxehtësin e epërm-/poshtëm max. 200 °C. Me 3D-ajrin e nxehtë ose ajrin e nxehtë max. 180 °C.
Biskota	Me nxehtësin e epërm-/poshtëm max. 190 °C. Me 3D-ajrin e nxehtë ose ajrin e nxehtë max. 170 °C. Vezët ose e verdha e vezëve e zvogëlon formimin e akrilamidit.
Pomfrit furre	Shpërndaheni gjellën në tepsi në mënyrë të njëtrajtshme dhe me një shtresë. Që pomfriti të mos thahet, piqni të paktën 400 g për tepsi

Këshilla për përdorimin

Këtu do të gjeni një sërë këshillash për enët dhe përgatitjen e gatesave.

Udhëzime

- Përdorni aksesoren e marrë bashkë me pajisjen. Aksesorët shtesë i gjeni si aksesorë të veçantë në dyqanet e specializuar ose pranë shërbimit të klientit.
Para përdorimit, nxirrni nga furra aksesorët dhe enët që nuk ju nevojiten.
- Përdorni gjithmonë një pecetë tenxheresh kur nxirrni aksesoren ose enën e nxehtë nga dhomëza e gatimit.

Pjekja

Kallëpet e pjekjes

- Përdorni mbi të gjitha kallëpe dhe tava të çelëta pjekjeje.
- Vendoseni kallëpin e kekëve gjithmonë në qendër të skarës së pjekjes dhe thekjes.

Këshilla për pjekjen

Kështu kuptoni nëse kekët e përzier janë pjekur mirë.	Rreth 10 minuta para përfundimit të kohës së pjekjes siç përcaktohet në recetë, shpjojeni me një kunj druri në pjesët më të larta. Kur tek druri nuk mbetet më brumë, do të thotë që keku është gati.
Keku bie.	Herën tjetër përdorni më pak ujë ose vendoseni në një temperaturë pjekjeje 10 gradë më të ulët. Respektoni kohët e dhëna të pjekjes në recetë.
Keku është fryrë në qendër dhe anash është i ulët.	Mos lyeni me pak yndyrë skajet e kallëpit mbërthyes. Pas pjekjes, shpëputeni kekun me kujdes me ndihmën e një thike.
Keku ka marrë ngjyrë shumë të errët nga sipër.	Shtyjeni më thellë, zgjidhni një temperaturë të ulët dhe lëreni kekun të piqet për më shumë kohë.
Keku është shumë i thatë.	Shponi në kekun e pjekur vrima të vogla me ndihmën e kruajtëses së dhëmbëve. Më pas pikoni lëng molle ose pije alkooolike sipër tij. Herën tjetër zgjidhni një temperaturë 10 gradë më të lartë dhe shkurtoni kohën e pjekjes.
Buka ose keku (p.sh. keku me djathë) duken mirë, por janë të qullët (hidhni sipër shirita uji)	Herën tjetër përdorni më pak ujë dhe piqeni në temperaturë më të ulët dhe për kohë më të gjatë. Për kekët me shtresë të lëngët, piqni njëherë pjesën e poshtme. Shtroni sipër bajamet ose peksimadhet dhe më pas shtroni shtresën e sipërme. Ju lutemi respektoni kohët e pjekjeve në receta.
Pasta nuk është pjekur në mënyrë të njëtrajtshme.	Zgjidhni një temperaturë disi më të ulët, që pasta të piqet njëtrajtshëm. Nëse vendosni sipër tyre letër gatimi, kjo mund të ndikojë në qarkullimin e ajrit. Letrën e gatimit copëtojeni gjithmonë sipas tavës.
Keku me fruta është shumë i çelët në pjesën e poshtme.	Herën tjetër shtyjeni kekët një nivel më thellë.
Lëngu i frutave rrjedh.	Herën tjetër përdorni një tavë universale, nëse keni një të tillë.
Ëmbëlsirat e vogla me brumë me maja ngjiten me njëra-tjetrën.	Lini rreth 2 cm hapësirë midis ëmbëlsirave. Kështu ka vend të mjaftueshëm që ëmbëlsirat të fryhen dhe të piqen nga të gjitha anët.
Gjatë pjekjes së kekëve të lëngshëm, formohet ujë i kondensuar.	Gjatë pjekjes mund të formohen avuj uji. Ata dalin nga pjesa e sipërme e derës. Këta avuj mund të bien në panelin e komandimit ose në pjesët ballore të mobilieve përçark dhe të pikojnë si ujë i kondensuar. Ky është një fenomen fizik.

Thekja dhe pjekja

Ena

Mund të përdorni çdo enë të qëndrueshme ndaj nxehtësisë. Vendoseni enën gjithmonë në qendër të skarës së ulët. Për copat e mëdha të mishit është e përshtatshme edhe tava e emaluar e pjekjes.

Këshilla për thekjen

- Një temperaturë e ulët mundëson një thekje më të njëtrajtshme.
- Në rastin e peshqve të hollë, shtoni 2 deri 3 lugë gjelle ujë, për zierje 8 deri 10 lugë gjelle, sipas përmasave.
- Tek rosat dhe patat, shponi lëkurën nën flatra, në mënyrë që të rrjedhë yndyrë.
- Pula do të marrë ngjyrë bojëkafë dhe do të theket, nëse pak para përfundimit të kohës së pjekjes e lyeni me gjalpë, ujë me kripë ose lëng portokalli.
- Kthejeni copat e mishit pas gjysmës së kohës.
- Kur pjekja është gati, duhet të qëndrojë edhe 10 minuta të tjera në furrë të fikur dhe të mbyllur. Kështu lëngu i mishit do të shpërndahet më mirë.
- Gjatë pjekjes së copave të mëdha të mishit mund të krijohet avull dhe rrjedhje përmes derës së furrës. Kjo është një dukuri normale, e cila nuk ka asnjë ndikim në funksionim. Pas procesit të pjekjes, thajeni derën e furrës dhe dritaren e saj prej xhami me një leckë.
- Kur piqni mbi skarë, për pritjen e yndyrave që rrjedhin, futni në lartësinë 1 tavën e pjekjes.

Këshilla për thekjen

Si mund të kuptoni nëse gatesa është pjekur.	Përdorni një termometër për mish (mund t'i gjeni në dyqan) ose bëni "provën e lugës". Shtypeni mishin me lugë. Nëse është i fortë, është pjekur. Nëse bie, i nevojitet pak më shumë kohë.
Mishi i pjekur është shumë i errët dhe lëkura është djegur vende-vende.	Kontrolloni lartësinë e skarës dhe temperaturën.
Mishi i thekur duket mirë, por lëngu është i djegur.	Herën tjetër zgjidhni një enë më të vogël për pjekjen dhe shtoni më shumë ujë.
Mishi i thekur duket mirë por lëngu është shumë i çelët dhe i hollë.	Herën tjetër përdorni një enë më të madhe për pjekje dhe hidhni më pak ujë.

Këshilla për pjekjen në skarë

- Mundësisht vendosni copa me trashësi të njëjtë në skarë. Ato duhet të jetë të paktën 2 deri 3 cm të trashë. Kështu do të theken njëtrajtshmërisht dhe do të qëndrojnë të lëngshëm.
- Vendoseni ushqimin për pjekje në mes të skarës. Shtoni pak ujë mbi tavën e emaluar të pjekjes dhe futeni atë për pritjen e yndyrave që rrjedhin, në lartësinë e poshtme. Mos e vendosni atë asnjëherë mbi bazamentin e dhomëzës së gatimit.
- Njomeni ushqimin për pjekje me pak vaj, para se ta vendosni atë mbi skarë nën gril.
- Kthejeni ushqimin për pjekje nëse është i hollë, pas gjysmës së kohës së pjekjes dhe kur është i trashë, kthejeni disa herë gjatë kohës së pjekjes. Për këtë përdorni një pincë skare, në mënyrë që ushqimi për pjekje të mos shpohet dhe lëngu i mishit të qëndrojë brenda, p.sh. në mishin që po piqni.
- Llojet e errët të mishit, si mishi i qengjit dhe i lopës, theken më shpejt dhe më mirë se sa mishi me ngjyrë të çelët i derrit dhe i viçit.
















Testuar për ju në studion tonë të gatimit

Këtu do të gjeni një sërë gatesash dhe rregullimet e tyre optimale. Ne do t'ju tregojmë se cili lloj ngrohjeje, temperature dhe lartësie është e përshtatshme për gatesën tuaj.

Udhëzime

- Të dhënat e kohës në tabela janë vlera standarde. Ato varen nga cilësia dhe dendësia e ushqimit.
- Përdorni aksesoren e marrë bashkë me pajisjen. Aksesorët shtesë i gjeni si aksesorë të veçantë në dyqanet e specializuar ose pranë shërbimit të klientit.
Para përdorimit, nxirrni nga furra aksesorët dhe enët që nuk ju nevojiten.
- Përdorni gjithmonë një pecetë tenxheresh kur nxirrni aksesoren ose enën e nxehtë nga dhomëza e gatimit.

Të gjitha të dhënat i referohen një furre të parangrohur.

Gatesa	Pesha (kg)	Rafti	Lloji i ngrohjes	Temperatura në °C	Kohëzgjatja në minuta
Lazanjë	3-4	1		200-230	50-60
Pastiço	2	1		220-230	40-45
Mish viçi i pjekur	1,5	2		180-190	70-80
Filetë derri	1	2		180-190	50-60
Mish i pjekur lepuri	1,5	2		180-190	70-80
Pulë e pjekur në gril	1	2		180-190	50-60
Pulë e pjekur në gril	2	2		180-190	80-90
Salsiçe	1	3		maks.	7-9 njëra anë 5-6 ana tjetër
Kotëletë derri	2	4		maks.	12-15 njëra anë 5-7 ana tjetër
Peshk i freskët	1,5	2		160-170	50-60
Picë e freskët	3	1		maks.	9-11
Bukë	2	2		190-200	40-50
Kekë me biskota	1	2		150-160	50-60
Torta të vogla me marmelatë	1	2		160-170	40-50
Briosh	1	2		160-170	25-30

Važne napomene za sigurnost	27
Uzroci oštećenja	28
Vaš novi uređaj	29
Birač funkcija	29
Birač temperature	29
Elektronski časovnik.....	29
Pribor.....	30
Pre prvog korišćenja	30
Podешavanje vremena	30
Zagrevanje rerne.....	30
Čišćenje pribora.....	30
Ovako rukujete Vašom rernom	31
Uključivanje rerne	31
Rukovanje elektronskim časovnikom	31
Podешavanje automatskog vremena uključivanja	31
Prikazivanje i promena podešenih vrednosti.....	32
Nega i čišćenje	32
Sredstva za čišćenje	32
Katalitička obloga pećnice.....	33
Demontaža i ugradnja stakla na vrata	33

Otkučivanje i zakačivanje vrata uređaja	34
Otkučivanje i zakačivanje rešetke za zakačivanje.....	34
Šta da učinite u slučaju smetnje?	35
Zamena lampice za rernu	35
Tablica smetnji	35
E-broj i FD-broj	35
Saveti za energiju i životnu sredinu	36
Ušteda energije	36
Rešavanje otpada u skladu sa zaštitom okoline	36
Akrilamid u hrani	36
Saveti za primenu	37
Pečenje	37
Pečenje i roštilj	38
Testirano za Vas u našem studiju za kuvanje	39

Ostale informacije o proizvodima, priboru, rezervnim delovima i servisima ćete naći na internetu: www.siemens-home.com
"online" prodavnici: www.siemens-eshop.com

Važne napomene za sigurnost

Pažljivo pročitajte ovo uputstvo. Jedino tako možete sigurno i pravilno da rukujete Vašim uređajem. Sačuvajte uputstvo za upotrebu i montažu za neku kasniju upotrebu ili za sledećeg vlasnika.

Ovaj uređaj je namenjen samo za ugradnju. Obratite pažnju na specijalno uputstvo za montažu.

Pošto ste ga raspakovali, proverite uređaj. Ukoliko oštetio prilikom transporta, nemojte ga priključivati.

Samo ovlašćeni stručnjak sme da priključuje uređaje bez utikača. U slučaju štete zbog pogrešnog priključka ne postoji zahtev za garancijom.

Ovaj uređaj je namenjen za privatno domaćinstvo i kućno okruženje. Uređaj koristite samo za pripremu jela i pića. Nadzirite uređaj tokom rada. Uređaj koristite samo u zatvorenim prostorijama.

Ovaj uređaj je namenjen za korišćenje na nadmorskim visinama od maksimalno 2000 metara.

Ovaj uređaj mogu koristiti deca od 8 godina i lica sa smanjenim psihičkim, osećajnim ili mentalnim sposobnostima ili nedostacima iskustva ili znanja, ako ih nadzire lice, koje je odgovorno za bezbednost, ili ih je uputilo u vezi sa sigurnom upotrebom uređaja i ako su oni razumeli opasnosti, koje iz toga mogu da nastanu.

Nikada ne smete pustiti decu da se igraju sa uređajem. Čišćenje i korisničko održavanje ne smeju da vrše deca, čak i ako imaju 8 godina ili više i ako imaju nadzor.
